

PROCESVERBAL
nga seanca e 4-ët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 11.07.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Dimitar Tanurov, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 4-ët të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 11:15 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.07.2025.
2. Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON -RADIO SHPK Strugë.
3. Të ndryshme

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 6 vota "pro" dhe një abstenim nga Viktor Pavlovski, miratoi Procesverbalin nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 07.07.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë. Ai shpjegoi se çdo transmetues është i detyruar të paguajë kompensim vjetor për transmetim televiziv dhe radio, në afatin e përcaktuar me LSHMAAV. Radio JON-RADIO, si transmetues me leje për mbulim kombëtar, është i detyruar të paguajë kompensim vjetor në shumë prej 885.315,00 denarë. Pas dhënies së faturës, pagesa duhet të kryhet në afat prej 30 ditësh. Për shkak të mospagesës së kompensimit në afatin e parashikuar, Këshilli i Agjencisë ka inicuar procedurë për heqjen e lejes. Gjatë procedurës, transmetuesi informoi Agjencinë se, me kërkesë të përmbaruesit nga Struga, llogaria e tij ishte bllokuar për shkak të një borxhi të supozuar ndaj Ndërmarrjes Publike Radiodifuzioni i Maqedonisë, megjithëse, sipas transmetuesit, borxhi nuk ekzistonte. Meqenëse transmetuesi shprehu gatishmërinë për të shlyer detyrimin, por në pajtim me Ligjin për disiplinën financiare, nuk lejohet pagesa nga një llogari tjetër, person juridik ose fizik, në kushtet e një llogarie të bllokuar, ai kërkoi që procedura të ndërpritet për heqjen e lejes, derisa të zgjidhet problemi me përmbaruesin. Ndërkohë, transmetuesi paraqiti ankimim në gjykatën kompetente në Strugë. Këshilli i Agjencisë, duke marrë në konsideratë kërkesën, e ndërpreu përkohësisht procedurën dhe iu drejtua dy herë Gjykatës Themelore në Strugë, por nuk mori përgjigje për shkresat e dërguara. Gjatë ditës së djeshme, transmetuesi informoi Këshillin se problemi me përmbaruesin dhe Radiodifuzionin e Maqedonasë është tejkualuar dhe se shuma prej 885.315,00 denarë është paguar plotësisht. Duke marrë parasysh këto rrethana, Z. Trajçevski propozoi që Këshilli të miratojë Vendim për ndërprerje të procedurës së inicuar për heqjen e lejes. Gjatë miratimit të këtij Vendimi, u theksua se ekzistenca dhe funksionimi i JON Radio si radio me leje të nivelit kombëtar është me rëndësi të veçantë për pluralizmin mediatik në vend, pasi është e vetmja radio në nivel kombëtar që transmeton kryesisht programe në gjuhën shqipe.

Z. Xhurovski pyeti nëse në rastin me Radio JON – Strugë është shkelur Ligji për shkak të mosrespektimit të afateve ose për shkak të rrethanave që lidhen me përmbaruesin?

Z. Trajçevski shpjegoi se në pajtim me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, kur vendimi i një organi shtetëror varet nga veprimi i organi tjetër kompetent, procedura mund të ndërpritet derisa të merret vendim ose akt i përshtatshëm nga ai organ. Në rastin konkret, Agjencia e ndërpreu procedurën në pritje të vendimi ose akti ligjor nga Gjykata Themelore në Strugë. Edhe pse gjykata nuk iu përgjigj dy shkresave të dërguara nga Agjencia, transmetuesi mëvetësishëm ka tejkualuar problemin me përmbaruesin dhe ka kryer pagesën, duke eliminuar kështu arsyen e pezullimit. Z. Trajçevski shtoi se në rastet kur ka lidhje me autoritet tjetër kompetent, Ligji lejon vazhdimin e afateve. Nëse një lidhje e tillë nuk do të ekzistonte, afatet nuk mund të vazhdoreshin dhe procedura do të duhej të vazhdonte në pajtim me procedurën e rregullt ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON -RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023, e cila u ndërpre me Aktvendimin PA1 nr.08-162 datë 02.06.2025, për shkak se transmetuesi ka kryer pagesën e kompensimit vjetor për lejes e transmetimit në radio.

Në pajtim me Njoftimin nr.05-2090/2 datë 09.07.2025, dorëzuar nga Sektori për financa dhe logjistikë, SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, me datë 09.07.2025, ka kryer pagesën plotësisht në shumë prej 885.315,00 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) denarë, për kompensim vjetor të lejes për transmetim në radio, për periudhën nga 03.04.2025 deri me datë 02.04.2026, me anë të së cilës transmetuesi ka paguar plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho STEFANOVSKI**